



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania

Mob:+355(0)682084945

E: info@helpthelife.org.al

W: www.helpthelife.org

TERMA REFERENCE (ToR)

Pozicioni: Sanitar

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara

Organizata: Shoqata “Ndhmoni Jetën”

Vendndodhja: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj (me mundësi rinovimi)

Forma e punësimit: Me kohë të plotë

1. Hyrje – Qëllimi i qendrës

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara, e administruar nga Shoqata “Ndhmoni Jetën”, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, dhe mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me çrregullim të spektrit të autizmit, si dhe për familjet dhe kujdestarët e tyre. Qendra synon të përmirësojë cilësinë e jetës së përfituesve, të rrisë pavarësinë, autonominë dhe aftësitë funksionale të tyre, si dhe të promovojë përfshirjen aktive sociale dhe komunitare, në përputhje me parimet e jetesës së pavarur, barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

2. Përshkrimi i rolit

Sanitari është përgjegjës për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në ambientet e Qendrës Sociale Multifunkionale, duke siguruar kushte të sigurta dhe të shëndetshme për stafin dhe përdoruesit e qendrës.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

Punonjësi/ja do të:

- Kryejë pastrimin dhe dezinfektimin e të gjitha ambienteve të qendrës sipas planit të përcaktuar.
- Sigurojë furnizimet higjienike (p.sh., detergjentë, sapunë, letra higjienike) dhe të raportojë mungesat tek stafi përgjegjës.
- Mbajë ambientet e qendrës të pastra, të rregullta dhe të sigurta në mënyrë të vazhdueshme.
- Bashkëpunojë me stafin e qendrës për të garantuar kushtet higjienike gjatë të gjitha aktiviteteve.
- Përdorë pajisjet dhe materialet e pastrimit në mënyrë të sigurt dhe korrekte.

4. Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit

- Arsimi minimal i mesëm.
- Përvojë e dëshmuar në pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve.
- Njohuri mbi standardet bazë të higjienës dhe dezinfektimit.
- Përkujdesje, disiplinë dhe përgjegjshmëri.
- Aftësi për të punuar në ekip dhe për të komunikuar në mënyrë efektive.

5. Procedura e aplikimit



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
E: info@helphthelife.org.al
W: www.helphthelife.org

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Terma Reference, ftohen të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 30.01.2026, ora 17:00:

- Letër motivimi, ku të shpjegohet interesi për pozicionin dhe mënyra se si kandidati/ja i plotëson kriteret e kërkuara;
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Kopje e diplomës së Shkollës
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata trajnimesh, referenca pune, etj.), nëse aplikohen.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën e email: info@helphthelife.org.al me subjekt : Aplikim per pune (duke specifikuar pozicionin e dëshiruar).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes.